

Ac.nr.768/2015

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Isa Kelmendi, kryetar i kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Ramë Hyseni, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit E.I. nga..., kundër të paditurës J.S. nga..., për shkak të besimit të fëmijëve të mitur, duke vendosur sipas ankesës e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, C nr. 315/2014, të datës 26.12.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 09.06.2015, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës e të paditurës, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjilan-Dega në Viti, C nr. 315/2014, të datës 26.12.2014 dhe **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit E.I. nga... ndaj të paditurës J.S. nga..., për besimin, ruajtje dhe edukimin e fëmijëve të mitur, I.I. i lindur me ... dhe e mitura R.S. e lindur ... ashtu që fëmijët e mitur ti besohen paditësit në ruajtje mbajtje dhe edukim dhe të detyrohet e paditura që fëmijët e mitur të lindur në bashkësinë jashtë martesore e që janë nën përkujdesje të saj, t'ia dorëzoj paditësit në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së aktgjykimit si e pabazuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar gjykata e shkallës së parë nën pikën I. të dispozitivit e aprovon kërkesëpadinë e paditësit E.I. nga ..., ndaj të paditurës J.S. nga..., për besimin, ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur I.I., i lindur me ... dhe e mitura R.S. e lindur me ... nën pikën II të dispozitivit fëmijët e mitur I.I., dhe R.S., në të ardhmen i besohen në ruajtje dhe edukim E.I. nga ... si baba i tyre . Në pikën III të dispozitivit detyrohet E.I., si baba biologjik i fëmijëve t'ia lejoj kontaktin me fëmijët e mitur nënës së tyre biologjike J.S.. Kontakti me fëmijët e saj do të jetë dhe realizohet 2 herë në muaj nga një orë duke filluar nga ora 10:30 deri 11:30 dhe atë të premtën e parë dhe të tretë të çdo muaj, me ndërmjetësimin e organit të kujdestarisë pranë Qendrës për Punë Sociale në Viti. Njëherit u vendos që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet apo i njëjti të prishet dhe lënda ti kthehet gjykatës të shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësi në përgjigje në ankesë thekson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore , propozon që ankesa të refuzohet si e pabazuar gjersa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar , pretendimet ankimore dhe ato në përgjigje në ankesë, e pas vlerësimit të tyre , konform nenit 194 të LPK-së , gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi dhe e paditura kanë jetuar në bashkësi jashtë martesore nga viti 2008 deri në maj të vitit 2013. Në këtë bashkësi martesore kanë 2 fëmijët e mitur I.I. i lindur me ... dhe R.S. e lindur me ... Për shkak të çrregullimit të raporteve mes ndërgjyqësve kjo bashkësi jashtë martesore faktikisht ka pushua me dt. 14.04.2013 dhe ndërgjyqësit jetojnë ndaras. Qysh nga pushimi faktik të bashkësisë martesore fëmijët e mitur jetojnë me të paditurën-nënë . Objekt i këtij kontesti është ndryshimi i vendimit përkatësisht besimi i fëmijëve të mitur babës. Gjykata e shkallës së parë gjatë procedurës kontestimore ka nxjerr provat përkatëse dhe me aktgjykim C nr. 394/2013, e aprovon kërkesëpadinë e paditësit duke u bazuar në raportin e Qendrës për Punë Sociale në Viti, nr. 148/2014, të dt. 17.03.2014. Kundër këtij aktgjykimi e paditura parashtron ankesë dhe i njëjti priset me aktvendim Ac nr. 2436/14 të dt. 07.07.2014, të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Kjo për shkak të marrjes së mendimit të ekspertit –psikologut përkitazi se kujt duhet besuar fëmijët e mitur në ruajtje mbajtje dhe edukim.

Në ri-procedurë gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të gjykatës të shkallës së dytë të dhëna në aktvendim Ac nr. 2436/14 të dt. 07.07.2014, nxjerr provat përkatëse dhe nga raporti i qendrës për punë sociale në Viti nr.495/14 të dt. 12.12.2014, rezulton se fëmijët e mitur duhet besuar në ruajtje, mbajtje dhe edukim, babait përkatësisht paditësit. Nga ana tjetër nga mendimi i ekspertit psikologut V.J., rezulton se është në interes të fëmijëve të mitur që nëna të vazhdon të kujdeset për ta edhe për një kohë për shkak të moshës së tyre. Normalisht duke u mundësuar kontaktin me babin . Gjykata e shkallës së parë për të eliminuar kundërthëniet në mes të raportit të qendrës për punë sociale dhe mendimit të ekspertit mban seancë me dt. 26.12.2014 në prezencë të ekspertes dhe e njëjta mbetet pranë mendimit me shkrim se fëmijët e mitur për shkak të moshës së re dhe lidhjes emocionale me nënën duhet të mbesin në përkujdesje të nënës.

Duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka vendosur më afërsisht e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar. Këtë me arsyetim se pavarësisht mendimit të ekspertit psikologut , gjykata i fali besimin raportit të qendrës për punë sociale për shkak se punëtorët social kanë qenë në vazhdimësi në kontakt me këta dy bashkëshort si dhe fëmijët e mitur dhe se e paditura nuk ka mundësi ekonomike që të kujdeset për fëmijët e mitur.

Konstatimet juridike dhe qëndrimin juridik të gjykatës të shkallës së parë nuk e aprovon edhe gjykata e apelit si të rregullt dhe të bazuar me ligj. Në të vërtetë aktgjykimi i atakuar nuk

është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 .2 të LPK, të cilat gjykata e shkallës së dytë i vështron sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Gjykata e shkallës së parë po ashtu në tërësi dhe rregullisht e ka vërtetuar gjendjen faktike , por në këtë gjendje faktike të vërtetuar rregullisht dhe tërësisht gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar edhe të drejtën materiale dhe për këtë arsye aktgjykimi i atakuar u dashtë të ndryshohet e në bazë të nenit 195 . 1 nën pikën e) të LPK.

Këtë qëndrim gjykata e apelit e mori për arsye se me dispozitën e nenit 144 të Ligjit për familjet në Kosovë është parashikuar që gjykata përkatësisht organi i kujdestarisë i cili merr vendim për besimin e fëmijëve për ruajtje dhe edukim ka për detyrë ti hetoj në mënyrë të përshtatshme të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijut dhe me rastin e marrjes së vendimit të nisët në radhë të parë nga interesat e tij. Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë fare arsye për faktet që kanë të bëjnë me moshën e re të fëmijëve të cilët jetojnë me nënë për lidhjet emocionale të tyre me nënën , por këto arsye të dhëna në raportet e qendrës për punë sociale janë të pamjaftueshme për marrjen e vendimit përkatës nga gjykata për kundër mendimit të ekspertit përkatës psikologut i cili jep arsye të mjaftuara që fëmijët e mitur të mbesin në ruajtje, mbajtje dhe edukim nënës te e cila gjenden . Mendimin e ekspertit kjo gjykatë i fali besimin në tërësi , për arsye se fëmijët e mitur që nga koha e ndërprerjes faktike të bashkësisë jashtë martesore jetojnë me nënën , ashtu që ata emocionalisht janë të lidhur me të dhe janë adaptuar në atë rreth , prandaj është në interesin e fëmijëve të jetojnë me nënën që do të thotë se interesat e prindërve vijnë në rend të dytë . Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit V.J.- psikologut del se është në interes të fëmijëve të mitur që të mbesin në edukim dhe zhvillim me nënën e tyre , për shkak të lidhjeve emocionale e nënës me fëmijët që janë krijuar për shkak të jetës së përbashkët të pandërprerë . Të miturit një kohë të gjatë jetojnë në një ambient, me një mentalitet dhe edukatë të vendit që gjenden dhe se për shkak të moshës së fëmijëve shumë të re janë ambientuar në këtë rreth dhe janë adaptuar me mentalitetin e të njëjtit rreth. Të gjithë këta faktor vlerësuar në mënyrë kumulatiave janë bindës dhe vendimtar që të miturit edhe më tutje të vazhdojnë jetën me nënën , për arsye se ndërrimi i vendbanimit të deri tashëm dhe vendosja e tyre në ndonjë rrethanë tjetër kishte për të pasur ndikim negativ në aspektin e zhvillimit psikik dhe fizik për të miturit . Prandaj, eksperti preferon që fëmijët e mitur të mbesin në ruajtje mbajtje dhe edukim te nëna për deri sa babait ti mundësohet kontakti me fëmijë. Mendimin e ekspertit kjo gjykatë e aprovon si të drejtë dhe objektiv dhe nuk ka arsye të dyshohet në njëanshmërinë e tij. Nga këto arsye aktgjykimi i atakuar u dashtë të ndryshohet dhe të vendoset si në dispozitiv .

Kjo gjykatë nuk ka vendosur sa i përket kontakteve të prindit i cili nuk e ushtron kujdesin prindor me fëmijët e mitur për arsye se në këtë drejtim nuk ka pasur kërkesë , nga shkresat e lëndës rezulton se kontakti është realizuar në mënyrë të duhur edhe para inicimit të kësaj procedure . Nga ana tjetër kjo çështje në rast kontesti e po ashtu sa i përket ushqimisë mund të zgjidhet në kontest të posaçëm eventual.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimin.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.768/15 të dt.09.06.2015

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari
Isa Kelmendi.d.v.